



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:019212

Datë: 14.08.2024

Numri i dokumentit: 06048776

C.nr.66/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M nga Prizreni, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit-DKA, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit pagesë e borxhit, pas seancës së mbajtur më datën 14.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia paditësit A.M nga Prizreni, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit-DKA, në çështjen kontestimore, C.nr.66/2022.

DETYROHET paditësi A.M nga Prizreni, që të paditurës Komuna e Rahovecit-DKA, në emër të shpenzimeve gjyqësore t’ia paguajë shumën prej 171.60 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Paditësi A.M nga Prizreni, në këtë gjykatë më datën 31.01.2022, ka parashtruar padinë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit-DKA, për shkak të objektit të kontestit kompensimi i ushqimit në punë.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë për datën 14.08.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, ndërsa paditësi edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata ka vendosur ta konsiderojë të tërhequr padinë e paditësit për faktin se paditësi edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 14.08.2024, i njëjti nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Kështu, në nenin 409.1 të LPK-së parashihet që *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 456.1 të LPK-së ku është llogaritur përpilimi i përgjigjes në padi në shumën prej 104.00 euro dhe ½ e shumës për një seancë në shumën prej 67.60 euro.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 409.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.66/2022, më datën 14.08.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.